

## Vijojnë Aktivitetet e KLSH-së në kuadër të Muajit të Hapur për periudhën 8-16 Nëntor 2019

### **Prezantimi i dy auditimeve më të mira të zhvilluara gjatë vitit 2019 nga Departamenti i Auditimit të Institucioneve Qëndrore u zhvillua në ambientet e KLSH-së**

Në datën 08.11.2019 në kuadër të aktiviteteve të Muajit të Hapur në KLSH, nga Departamenti i Auditimit të Institucioneve Qëndrore u organizua prezantimi dhe diskutimi mbi auditimet me impakt për publikun si dhe të trajtuara gjerësisht në median e shkruar për shkak të problematikës tepër të ndjeshme që është trajtuar në këto auditime të kryera nga ky departament. Një nga prezantimet e përzgjedhura ishte mbi auditimin e ushtruar në Autoritetin Kombëtar të Ushqimit, Tiranë, i cili u prezantua nga Kryeaudituesi i Departamentit znj. Marjola Llanaj, me objekt “*Auditimin Financiar dhe Përputhshmërie*”, për periudhën 01.01.2017 deri në 31.12.2018, mbi saktësinë, vërtetësinë dhe besueshmërinë e ndërtimit të pasqyrave financiare, shkallës së zbatueshmërisë nga subjekti, të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, u konstatuan devijime/shkelje nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi, të rëndësishme materiale për të cilën japim *opinion të kualifikuar, miratuar me Vendim të Kryetarit 22, Datë 28/07/2019.*

Znj.Llanaj e nisi prezantimin me informacion njohës mbi aktivitetin e institucionit si dhe mbi standardet e auditimit ku grupi i auditimit u mbështet për kryerjen e këtij auditimi. U diskutuan çështjet më të rëndësishme, mbi të cilat u mbështet dhënia e opinionit të kualifikuar të përputhshmërisë në AKU si dhe në mënyrë të përmbledhur mbi Indicien penale të depozituar pranë Organit të Prokurorisë për AKU.

U prezantuan gjetjet dhe metodikat e përdorura lidhur me auditimin e praktikave të importeve për Produktet e Mbrojtjes së Bimëve (PMB) të importuara konstatohet se në territorin e Republikës së Shqipërisë qarkullojnë PMB të cilat blihen dhe importohen jashtë vendeve të BE, duke e ilustruar me raste konkrete.

U prezantuan gjetje mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin, mbi krijimin e të ardhurave dytësore apo regjistrimin e aseteve, etj.

Prezantimi i dytë ishte mbi auditimin të përputhshmërisë dhe rregullshmërisë në Muzeun Historik Kombëtar, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 20, datë 27.07.2019.

Ky auditim u prezantua nga audituesja Melina Kabo.



Znj Kabo e nisi prezantimin me informacion njohës mbi aktivitetin e institucionit si dhe mbi standardet e auditimit ku grupi i auditimit u mbështet për kryerjen e këtij auditimi. U diskutuan çështjet më të rëndësishme, mbi të cilat u mbështet dhënia e opinionit të kualifikuar të përputhshmërisë në MHK si:

- thyerje materiale të sistemeve të kontrollit përgjatë procesit të transferimit të ikonave për qëllime restaurimi, pasi kanë munguar procedura/rregullore të brendshme që të përshkruajnë proceset që duhen ndjekur për zhvendosjen e tyre shoqëruar me përcaktimin e qartë të roleve dhe përgjegjësi të sektorëve/pozicioneve/palëve të përfshira në proces; gjithashtu mosplotësimi i kartelave dhe pasaportave të ikonave, me informacionin përkatës mbi historikun e restaurimeve/konservimeve të kryera ndër vite, ka cënuar gjurmimin e procesit në vetvete; mungesa e buxheteve për krijimin e kushteve të përshtatshme të konfortit ka shkaktuar dëmtime dhe problematika të përsëritura. Sa më sipër ka bërë që këto objekte të trashëgimisë kulturore, me vlera të pazëvendësueshme të pasurisë kombëtare, të jenë vazhdimisht të ekspozuara përpara riskut të prishjes, humbjes, vjedhjes, pra “degradimit” të tyre.

- thyerje të kontrolleve përgjatë procesit të krijimit të të ardhurave dytësore (shitja e biletave), duke kufizuar audituesit në dhënien e sigurisë së arsyeshme mbi shifrat e deklaruara për këtë zë. Duke qenë burim kryesor i të ardhurave që menaxhohen nga vetë Muzeu, për proceset që gjenerojnë këtë kategori të ardhurash, duhet të tregohet kujdesi i duhur në mënyrë që ato t’i nënshtrohen menjëherë rregullave të disiplinës financiare., si dhe

- thyerje të sistemeve të kontrollit që lidhen me mungesën e procedurave transparente të rekrutimit, shtuar kësaj mungesën e përshkrimit të punës dhe si pasojë mungesën e kualifikimeve të kërkuara për pozicionet.

Znj. Kabo, u ndal më së shumti në interpretimin e gjetjeve që lidhen me inventarizmin dhe zhvendosjen e ikonave si pjesë e rëndësishme e trashëgimisë kulturore dhe nevojën që për ikonat që janë restauruar deri tani por edhe ato që do t’i nënshtrohen këtij procesi në vijim, të merren masa që të gjitha ndërhyrjet të pasqyrohen në pasaportën dhe në kartelën e objektit të restauruar.

Konstatimet ngjallën interes te kolegët e departamentit dhe çështje të caktuara u bënë burim diskutimi interaktiv dhe shkëmbimi njohurish mes kolegësh.

### **Në datën 11 nëntor në sallën “Lech Kaczynski” në KLSH, z.Fatos Çoçoli prezantoi dy botime të KLSH, të realizuara gjatë vitit 2019:**

- Dokumente të Kryetarit 2016-2018;
- Audituesit e KLSH në shtypin e përditshëm, Volumi XII.



Ky botim vjen në vijim të botimit “4 vjet Auditimi i Jashtëm Publik” (2012-2015) dhe i referohet aktivitetit të Kontrollit të Lartë të Shtetit për periudhën tre vjeçare 2016-2018. Në të

njëjtën linjë me këto dy botime, KLSH ka botuar edhe librin “*Dokumente të Këshillit Kontrollues 1925-1939*”.

Zoti Çoçoli referoi lidhur me të shtatë kapitujt që ka libri, në të cilët përfshihen Raportimet e Kryetarit të KLSH-së në Komisionin e Ekonomisë dhe Financave dhe Kuvendin e Shqipërisë; Artikuj të botuar në shtypin e përditshëm; Shkrime në Revistën Kërkimore-Shkencore “Auditimi Publik”; Diskutime në Analizat Vjetore të KLSH-së; Prezantime dhe kumtesa në Konferenca Shkencore, etj

Në kolanën e botimeve të KLSH-së bëjnë pjesë 12 botime krejt të veçanta (një enciklopedi), “*Audituesit e KLSH-së në median e shkruar*”, referuar shkrimeve të audituesve të KLSH-së në periudhën 2013- gusht 2019. Artikujt, analizat dhe editorialet e audituesve të KLSH-së përbëjnë pa dyshim një vlerë të shtuar në median shqiptare, duke rritur transparencën e veprimtarisë së institucionit. Zoti Çoçoli bëri një sintezë të librit dhe evidentoi shkrimet më të mira dhe problematikën e trajtuar nga audituesit.

### **Promovohet libri “Historia e Mendimit Shqiptar” i studiuesit Ndrëçim Kulla**

Në datën 11 nëntor 2019, në Hotel Tirana Internacional, u zhvillua promovimi i librit “Historia e Mendimit Shqiptar”, i studiuesit Ndrëçim Kulla, botim i cili vjen si një vështrim historik, kulturor, sociologjik dhe psikologjik mbi kombin shqiptar.



Në promovimin e librit morën pjesë Kryetari i KLSH, z. Bujar Leskaj si dhe të ftuar e pjesëmarrës që përfshinin gjithë fushat, studiues, pedagogë, filozofë, mjekë, politikanë, juristë, auditues të KLSH-së, etj.



Ky libër, përfshin të gjitha rrjedhat e mendimit shqiptar, që në gjurmët dhe filizat e tij kur u kristalizua, shkollat dhe rrymat e tij, tiparet dhe aktualitetin e tij të jashtëzakonshëm dhe do të plotësojë një boshllëk të madh për kulturën dhe shkencën shqiptare. Brezat e sotëm dhe të ardhshëm duhet të vihen në lidhje dhe ta njohin këtë literaturë, ashtu siç njohin edhe literaturën e letërsisë dhe historisë, e cila në dallim të dukshëm nga kjo literaturë është e programuar në mësimdhënie, duke i ponderuar orë të shumta.



Botimi i këtij mendimi në trajtën e një libri studimor vjen, si një literaturë shumë e përshtatshme edhe në procesin e mësim-dhënies në të gjitha nivelet e shkollave tona, në mënyrë që mësuesit dhe nxënësit, të arrijnë që brenda procesit mësimor të zgjerojnë njohjet dhe dijet e tyre mbi veprat dhe kontributin e intelektualëve shqiptarë të viteve 1870-1945, por edhe më thellë në histori. Komunikimi i vlerave të këtij libri do të ndikojë pozitivisht në, përdorimin e tij si literaturë konkretizuese dhe evidentuese, si dhe do të sigurojë një kontakt të drejtpërdrejtë e të profilizuar të mësuesve dhe nxënësve me materialin autentik të këtyre autorëve. Do t'i ushtrojë nxënësit ose studentët që, nën drejtimin e mësuesit ose pedagogut, të mësojnë të punojnë me materialin burimor dhe me mënyrën e vjeljes së tij përmes skedave, fishave dhe tabelave, por dhe në drejtim të edukimit demokratik dhe patriotik të nxënësve, ngjalljes dhe forcimit të krenarisë së ligjshme për figurat madhore të kombit tonë në kulturë e mendim, shoqëruar me vlerat e tyre më të spikatura në këto fusha. Në perspektivën e hapjes së një rruge dhe praktike të re pune në lëndë të tilla specifike si sociologji, edukim demokratik, filozofi e psikologji, duke konkretizuar kështu edhe aktivitetin e mendimtarëve shqiptarë në to.

**Në datën 12 nëntor në sallën e KLSH-së, “Gene Dodaro”, Departamenti i Auditimit të Buxhetit të Shtetit prezantoi dy auditimet më të mira të zhvilluara gjatë vitit 2019**

Departamenti i Auditimit të Buxhetit të Shtetit organizoi prezantimin e dy auditimeve më të mira të kryera gjatë vitit 2018. Këto auditime ishin dy auditime përputhshmërie përkatësisht: auditimi në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë “Mbi Zbatimin e Buxhetit të Shtetit për vitin 2018” si dhe auditimi i kryer në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve “Mbi përputhshmërinë e aktivitetit për periudhën 1.1.2018-31.12.2018”.

Prezantimi i auditimit “Mbi Zbatimin e Buxhetit të Shtetit për vitin 2018” u përgatit dhe prezantua nga z. Rigels Guzi, auditues i lartë pranë departamentit. Prezantimi përfshinte një përmbledhje të çështjeve të audituara dhe të shoqëruara me shembuj të fenomeneve më kryesore në lidhje më të cilat KLSH konstaton se vazhdojnë të mbeten si problematika të konstatuara edhe në auditimin e mëparshëm. Këto çështje ishin:

- Angazhimet buxhetore jo në përputhje me kuadrin ligjor shkak për rritjen e stokut të detyrimeve të prapambetura;
- Procedurat e menaxhimit të investimeve publike;
- Mungesa e prioritetit në buxhetim shoqëruar me akte normative të cilat nuk përmbajnë në vetvete projekte të reja;
- Detyrimet e prapambetura: mënyra e raportimit nga njësitë nuk siguron saktësinë dhe plotësinë e këtij komponenti;
- Pushteti vendor;
- Financimi i huaj;
- Nënvleresimi i shpenzimeve;
- TVSH e rimbursueshme,
- Vlerësimi i përputhshmërisë në rregjistrimet e kryera në sistemin e thesarit.

Prezantimi i auditimit “Mbi përputhshmërinë e aktivitetit për periudhën 01.01.2018-31.12.2018” u përgatit dhe prezantua nga zj. Selime Bregu, audituese e lartë pranë departamentit. Prezantimi përfshinte një përmbledhje të çështjeve të audituara dhe të shoqëruara me gjetjet më kryesore. Këto çështje ishin:

- Planifikimi dhe realizimi i të ardhurave tatimore;
- Procesi për identifikimin dhe vlerësimin e pretendimeve për rimbursimin e TVSH-së;
- Funksionimin e disa prej drejtorive më kryesore;
- Evidentimi dhe ndjekja e borxhit tatimor.

Të dy prezantuesit, si përfaqësues të grupeve të auditimit folën dhe për sfidat që këto dy auditime mbartin për shkak të volumit të madh të të dhënave, kompleksitetit dhe sensibilitetit publik për çështje si: borxhi publik, deficitin, dividenti.

Në këtë prezantim morën pjesë aktive të gjithë audituesit e Departamentit shoqëruar me pyetje dhe diskutime mbi çështjet e trajtuara në këto auditime, gjetjet, metodën dhe qasjen e auditimit.

### **Takim mbi Auditimin e eficiencës së menaxhimit të ndërhyrjes në rast të ndotjes së papritur në Detin Adriatik, zhvilluar në Rijeka të Kroacisë**

Në datat 12-13 nëntor u zhvillua në Rijeka, Kroaci, takimi i parë për rakordimin e auditimit paralel me fokus “Ndotja e menjëhershme e deteve”. Në këtë takim morën pjesë përfaqësues të zyrave të auditimit suprem të Shqipërisë, Kroacisë, Sllovenisë, Italisë, Malit të Zi dhe Bosnje-Hercegovinës. Ideja e një auditimi të tillë lindi nga bashkëpunimi i mëparshëm, në kuadër të projektit IPA, i drejtuesve të auditimit të performancës në SAI-t e Kroacisë dhe Shqipërisë, konkretisht z. Božo Vuletić-Antić dhe z. Rinald Muça.



Mbështetur në suksesin e dy auditimeve të performancës në bashkëpunim me SAI-n kroat, realizuar në periudhën 2017-2018, auditimit mbi “Zhvillimin Strategjik të Turizmit” dhe atij mbi “Cilësinë e ndërtesave shkollorë” dhe në përmbushje të motos së INTOSAI-t “Eksperienca e përbashkët i vlen të gjithëve”, u konkludua se një fushë me interes potencial për të shtrirë bashkëpunimin e mëtejshëm është ajo mjedisore dhe veçanërisht ajo e pasurive të përbashkëta natyrore, siç është deti Adriatik.

Në përfundim të takimit, audituesit informuan kolegët lidhur me aktivitetet e Muajit të Hapur që po zhvillon KLSH.

**Në datat 13-17 nëntor 2019, Kontrolli i Lartë i Shtetit mori pjesë në edicionin e XXII-të të Panairit të Librit**, në Tiranë, duke shënuar kështu për të shtatin vit radhazi një pjesëmarrje dinjitoze, duke u paraqitur me 109 botime përkundrejt 17 botimeve të vitit 2013, kur mori pjesë për herë të parë në këtë panair.

Në datën 15 nëntor u bë promovimi i kolanës së botimeve të KLSH-së në Pallatin e Kongreseve.



Në panairin e këtij viti, KLSH u paraqit me 109 tituj, ndër të cilët :

- 22 numra të Revistës Shkencore “Auditimi Publik” në gjuhën shqipe dhe angleze;
- 7 analiza vjetore të punës së KLSH-së;
- 8 botime që i dedikohen Performances së institucionit në shqip dhe në anglisht;
- 12 volume të shkrimeve të përmbledhura të audituesve në shtypin e përditshëm;
- 6 volume që lidhen me Konferencat Shkencore vjetore të KLSH-së;
- Tituj te tjerë që pasqyrojnë auditimet e KLSH-së në vitet 2012-2018, strategjitë e KLSH-së, historikun e INTOSAI-t, rregulloret e KLSH-së, etj

**Në datën 14 nëntor 2019, Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Dr. Bujar Leskaj dhe Rektori i Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, Prof.Dr.Adem Bekteshi nënshkruan një Marrëveshje Bashkëpunimi në ambientet e KLSH-së, në kuadër të Muajit të Hapur që po zhvillon institucioni.**



Marrëveshja vjen në kuadër të interesit të përbashkët për të bashkëpunuar në rritjen e kapaciteteve dhe njohurive profesionale të stafit të Kontrollit të Lartë të Shtetit në njërën anë, si dhe në zhvillimin e kurrikulave, mendimit shkencor të Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, në anën tjetër, përmes kontributit që ofron KLSH-ja si institucioni më i lartë i

kontrollit ekonomik e financiar, i cili ndihmon në përmirësimin e menaxhimit të fondeve publike nga Qeveria dhe entet e tjera publike nëpërmjet auditimit.

**Në datën 14 Nëntor 2019**, në ambientet e Kontrollit të Lartë të Shtetit, z.Aldo Kita në kuadër të Muajit të Hapur, tashmë traditë e KLSH-së, u zhvillua një takim mes audituesve të KLSH, me temë diskutimi botimin e vitit 2019 **“Rregullorja e procedurave të Auditimit të KLSH-se & rregullorja e Sistemit të Menaxhimit të Proceseve”**.

KLSH është institucion i pavarur kushtetues, i ndërtuar që t'i shërbejë qytetarit shqiptar, të jetë “agjent” i Kuvendit dhe palëve të interesit duke i informuar ata në mënyrë të vazhdueshme, të paanshme dhe të plotë, mbi përgjegjshmërinë që qeveria dhe entet publike tregojnë në përdorimin e kontributit të taksapaguesve shqiptarë e duke kontribuar në përmirësimin e qeverisjes nëpërmjet luftës kundër korrupsionit.



Për arritjen e këtij misioni bazuar në praktikat më të mira ndërkombëtare duke vlerësuar domosdoshmërinë e përdorimit të teknologjinë e informacionit në rritjen e efektivitetit, efijencës dhe transparencës së procesit të auditimit KLSH në vitet e fundit ka vënë një fokus të veçantë në intensifikimin e përdorimit të metodave bashkëkohore të teknologjisë së informacionit duke bërë që ajo të jetë një nga instrumentet bazë të rritjes së performancës së punës së KLSH.

Zoti Kita theksoi se implementimi i sistemit të informacionit për menaxhimin e proceseve në Kontrollin e Lartë të Shtetit do të optimizojë procesin e auditimit duke respektuar parimet mbi të cilat ai mbështetet.

Rregullorja e Sistemit të Menaxhimit të Proceseve paraqet një pasqyrim të plotë të procedurave që ndiqen për menaxhimin, administrimin dhe përdorimin e sistemit të informacionit që Kontrolli i Lartë i Shtetit përdor për menaxhimin e proceseve të auditimit dhe atyre administrative.

Kjo rregullore ofron një dokumentim të plotë të udhëzimeve të nevojshme për përpunimin dhe ruajtjen e informacionit dhe proceseve që gjenerohen nëpërmjet sistemit të informacionit. Si një dokument i rëndësishëm për mirëfunksionimin e sistemit, kjo rregullore gjithashtu përcakton parimet e përgjithshme dhe masat organizative e teknike për mbrojtjen dhe ruajtjen e sigurisë së të dhënave.



**Në datën 15 nëntor**, Drejtoresha e Përgjithshme e KLSH-së, zj.Lindita Milo dhe audituesja zj.Amantja Patozi morën pjesë në Seminarin “**Rregullorja e përgjithshme për mbrojtjen e të dhënave**” që u zhvillua në Qipro.

Zyra e Auditimit të Republikës së Qipros, në bashkëpunim me Gjykatën Evropiane të Llogarive dhe Komisionin European, në kuadrin e aktiviteteve për Objektivin Strategjik nr 1, ”Mbi promovimin e institucioneve supreme të Auditimit (SAI) të pavarura, me njohuri shumë-disiplinore dhe të forta si dhe nxitjen e mirëqeverisjes së tyre”, organizuan një diskutim të detajuar mbi parimet e mbrojtjes së të dhënave personale dhe menaxhimin e tyre gjatë proceseve audituese, duke përfshirë grumbullimin, transferimin, arkivimin, të drejtën e aksesit, anonimatin dhe fshirjen e sigurt të të dhënave personale të subjekteve të audituara nga SAI-t.



***Shënim : Për aktivitetet e cituara më poshtë, të zhvilluara në kuadër të Muajit të Hapur në periudhën 11-16 nëntor, ka njoftime të veçanta dhe të zgjeruara në WEB-in e KLSH-së :***

- Takim mbi Auditimin e eficiencës së menaxhimit të ndërhyrjes në rast të ndotjes së papritur në Detin Adriatik, zhvilluar në Rijeka të Kroacisë;
- Në datat 13-17 nëntor 2019, Kontrolli i Lartë i Shtetit mori pjesë në edicionin e XXII-të të Panairit të Librit;
- Në datën 14 nëntor 2019, Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Dr. Bujar Leskaj dhe Rektori i Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, Prof.Dr.Adem Bekteshi nënshkruan një Marrëveshje Bashkëpunimi në ambientet e KLSH-së;
- KLSH merr pjesë në Seminarin e zhvilluar në Qipro, “Rregullorja e përgjithshme për mbrojtjen e të dhënave”.